



FTESË PËR OFERTIM Për shitjen e masës drunore

Numri referues i shitjes: 644 – 2018 – 001

Dt. 09.11.2018

NENI I: EMRI DHE ADRESA E AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

| | | |
|---|----------------------------------|---|
| Emri zyrtar: <i>Komuna Vushtrri</i> | | |
| Adresa Postare: <i>Rr. "Isa Boletini" nr. 44</i> | | |
| Qyteti: <i>Vushtrri</i> | Kodi postar: <i>38214</i> | Vendi: <i>Kosovë</i> |
| Personi përgjegjës: <i>Saranda Cakaj</i> Person kontaktues: <i>Hyda Dallku</i> | | Telefoni: <i>028 – 571 - 218</i> |
| Email: <i>Prokurimi.vushtrri@rks-gov.net</i> | | |
| Adresa e Internetit (nëse aplikohet): | | <i>"[shëno web e AK]"</i> |

NENI II: LËNDA E SHITJES

Autoriteti kontraktues ka për qëllim **shitjen e masës drunore për zjarr** përmes ofertave publike të mbyllura.

Masa drunore, në sasi prej 247.50m³ shiten/t në kushte "**siç janë, ku janë**" dhe Autoriteti Kontraktues nuk do të ketë përgjegjësi të mëtutjeshme pas shitjes. Tërheqja e aplikuesit nuk lejohet pas dorëzimit të aplikacionit.

| Komuna | Vend deponimi | Lloji i drurit | Sasia në m ³ | | Çmimi fillestar në €/m ³ | | Vlera fillestare në € |
|----------|---------------|----------------|-------------------------|----------------------|-------------------------------------|--------|-----------------------|
| | | | Teknik | Zjarri | Teknik | Zjarri | |
| Vushtrri | Vushtrri | I përzier | --- | 247.50m ³ | --- | 32.00€ | 7.920,00€ |

NENI III: INFORMATA ADMINISTRATIVE

Autoriteti Kontraktues fton ofertuesit që të marrin pjesë në Ankandin Publik me oferta të mbyllura, për blerje të **masës drunore** sikurse është theksuar më lartë në këtë Njoftim

NENI IV : Ofertimi është i hapur për të gjithë ofertuesit e interesuar që përmbushin kërkesat minimale për kualifikim, si vijon :

IV.1.1) Kërkesat për Pranueshmëri:

Për Personin Juridik :

Kërkesat :

1. Deklarata nën Betim për përmbushjen nga Op. Ek. të kërkesave për përshtatshmëri sikurse

është cekur në nenin 65 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

2. Vërtetimi nga Administrata Tatimore e Kosovës

Dëshmia e kërkuar dokumentare :

1. Deklarata nën betim se ju i përmbushni kërkesat për përshtatshmëri sikurse është cekur në nenin 65 të Ligjit Nr. 04/L-042, duhet të dorëzohet në (**Original**)
2. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit Tuaj të themelimit se Ju nuk jeni në vonesë për pagimin e tatimeve, ky vërtetim duhet të jetë jo më i vjetër se 90 ditë kalendarike nga data e hapjes së këtij aktiviteti), **duhet dorëzohet nga Op. Ek. të cilit synohet dhënia e kontratës** (**kopje**)

Për Personin Fizik :

Kërkesat :

1. Vërtetimi mbi pagesën e Tatimit në Pronë;
2. Letërnjoftimi

Dëshmia e kërkuar dokumentare :

1. Dëshmi mbi pagimin e Tatimit në Pronë në emër të parashtruesit të kërkesës, që përfshinë periudhën deri më **dt. 30.06.2018** (**duhet dorëzohet nga tenderuesi të cilit synohet dhënia e kontratës**), **duhet dorëzuar në** (**Original**)
2. Letërnjoftimi valid, duhet dorëzuar në (**kopje**)

IV.1.2) Përshtatshmëria profesionale:

Për personin Juridik :

Kërkesat :

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/ose të korporatës në vendin tuaj të Themelimit
2. Certifikata e numrit fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare :

1. Certifikata e regjistrimit të biznesit (e kompletuar) (**kopje**)
2. Certifikata e numrit fiskal (valide) (**kopje**)

Për Personin Fizik : N / A

NENI V : Kriteri për Dhënie e Kontratës :

a) Çmimi më i lartë i ofruar

NENI VI : Vizita është **Jo obligative. Të** interesuarit mundë të marrin pjesë vizitë me **13.11.2018**, takimi para objektit të komunës në ora **11:00**

NENI VII : Ofertat duhet të dorëzohen në zyrën e prokurimit, kati i dytë, **zyra nr. 45**, në objektin e komunës, me dy kopje (një origjinal dhe një kopje) të futura në një zarf tjetër të mbyllur.

NENI VIII : Afati i fundit për pranimin e kërkesave për dosjen e tenderit:

data : 21.11.2018 , koha : deri n'ora 12.00

NENI IX : Afati i fundit për dorëzimin e ofertave është data **22.11.2018 në ora 13:00, në adresën : Komuna Vushtrri, kati i II-të, zyra nr. 45.**

NENI X : Ofertat e dorëzuara pas orës 13.00 do të refuzohen.

NENI XI : Ofertat e dorëzuara me kohë do të hapen në prezencë të përfaqësuesve të ofertuesve të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në adresën e cekur më lartë në zyrën nr. 14, kati i dytë, më dt. **22.11.2018** në ora **13:30**

NENI XII - Këshillë Juridike :

Çdo palë e interesuar ka të drejtë të parashtrij ankese pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 108/A të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.